

YIHR dhe QESH denoncojnë psikiatrin kosovar për fjalor
urrejtës ndaj homoseksualëve

Dr. Ferit Agani akuzohet për fjalor urrejtës ndaj pakicave seksuale

Nisma e të rinjve për të drejtat e njeriut (YIHR) dhe Qendra për Emancipim Shoqëror (QESH) denoncojnë përhapjen e urrejtjes dhe dezinformimit në shkrimin e dr. Ferid Aganit, botuar më 26 shtator 2006 në gazetën "Iliria Post". Dr. Agani tha: "Homoseksualiteti është çrregullim serioz psikik"

PRISHTINË, 2 TETOR - Nisma e të rinjve për të drejtat e njeriut (YIHR) dhe Qendra për Emancipim Shoqëror (QESH) kanë denoncuar të hënën në një kumtesë për shtyp psikiatrin kosovar dr. Ferid Aganin për fjalor urrejtës kundër pakicave seksuale, duke u mbështetur në një shkrim që Agani ka botuar në të përditshmen "Iliria Post" dhe ku ai citohet të ketë thënë se "Homoseksualiteti është çrregullim serioz psikik".

"Homoseksualiteti është gjendje që gjer në të 80-tat është konsideruar si çrregullim dhe sëmundje nga Asociacioni i Psikologëve Amerikanë. Në ato vite, kjo gjendje është larguar nga ai regjistër dhe më nuk konsiderohet si çrregullim apo sëmundje, sepse profesionalisht mendohet se është baza gjenetike ajo që përcakton këtë gjendje. Sidoqoftë, mendimi im është se shkencë nuk e ka dhënë fjalën e fundit dhe mendoj se bazuar në përvojën time në klinikë, homoseksualiteti është çrregullim psikik i individit. Kështu që nuk është në pajtim me natyrën njerëzore", ka thënë Agani.

YIHR dhe QESH konsiderojnë se komentet e dr. Ferid Aganit, jo vetëm që janë tepër të gabueshme, por janë në kundërshtim me pikëpamjet e psikologëve dhe psikiatërve kryesorë në botë dhe nuk përmbajnë qëndrimet e qeverive më të përparuara që promovojnë të drejtat e njeriut.

Nisma e të rinjve për të drejtat e njeriut (YIHR) dhe Qendra për Emancipim Shoqëror (QESH) konsiderojnë se komentet diskriminuese të dr. Aganit kundër minoriteteve seksuale përmbajnë fjalor urrejtje, e definojnë si dezinformatë e rrezikshme që ka potencial të ushqejë jotolerancën, diskriminimin dhe dhunën kundër minoriteteve seksuale. YIHR dhe QESH me këtë rast kërkojnë që:

- (1) Dr. Ferid Agani të kërkojë falje publikisht për përdorimin e pozitës së tij profesionale si platformë që të vërë në shënjestër pakicat seksuale me fjalor urrejtje;
- (2) Asociacioni Ortopsikiatrik Amerikan, të shpallë të pavlefshme shpërblimet e dhëna dr. Aganit për kontributin e tij në fushën e shëndetit mental në Kosovë, tani që fjalori i tij ka shkaktuar dëm dhe stigmatizim social.
- (3) Gazeta ditore "Iliria Post" të publikojë faljen publike të dr. Aganit ose një falje të ngjashme



nga stafi redaktues i gazetës që do të dënonte fjalorin e urrejtjes kundër pakicave seksuale;

- (4) Komisioneri i përkohshëm i mediave në Kosovë të lëshojë një letër formale të pakënaqësisë kundër ditores "Iliria Post" për nxitjen e urrejtjes kundër pakicave seksuale nëpërmjet publikimit, dhe të kërkojë nga stafi i gazetës të marrin pjesë në trajnim për diversitetin si kusht për vazhdimin e mëtejshëm të punës;
- (5) Kryeministri i Kosovës dhe përfaqësuesi special i sekretarit të përgjithshëm që është përgjegjës për veprimet e administratës së Kombeve të Bashkuara në Kosovë të bëjnë deklaratë publike ku do të dënonin fjalorin e urrejtjes ndaj pakicave seksuale dhe grupeve të tjera të rrezikuara ndaj diskriminimit në Kosovë.